

**VENDIM**  
**Nr.754, datë 28.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,**  
**QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,**  
**KOMUNA QENDËR VLORË, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qendër Vlorë, të qarkut të Vlorës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 23 (njëzet e tre), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## 2.FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore. etj)

| Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU    |                     |                                       |                                                             |                  |                |             |                                       |                                                  |                                               |                                        |
|--------------------------------------------|---------------------|---------------------------------------|-------------------------------------------------------------|------------------|----------------|-------------|---------------------------------------|--------------------------------------------------|-----------------------------------------------|----------------------------------------|
| Komuna: Qendër                             |                     |                                       |                                                             |                  |                |             |                                       |                                                  |                                               |                                        |
| Fusha e përdorimit të pronës: pyll+kullote |                     |                                       |                                                             |                  |                |             |                                       |                                                  |                                               |                                        |
| Nr. ren.                                   | Nr i inv. sipas VKM | Emërtesa e ekonomisë pyjore/kullosore | Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërimit popullore) | Numri i parcelës | Destinacioni   | Sip. në ha, | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni, enti me përgjegjësi administrative | Institucioni, enti përdorues, statusi juridik | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta) |
| 0                                          | 1                   | 2                                     | 3                                                           | 4                | 5              | 6           | 7                                     | 8                                                | 9                                             | 10                                     |
| 1                                          | 1                   | EP Kume – Shashice                    | Plep zvernecit                                              | 3                | Sip.bim.pyj.   | 5           | Mbrojt. Toke                          | M M P A U                                        | D SH P                                        |                                        |
| 2                                          | 2                   | "                                     | Plepi zvernecit                                             | 4/a              | Pyll           | 35          | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 3                                          | 3                   | "                                     | Xhuherin –pishe                                             | 21a              | Pyll           | 1.5         | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 4                                          | 4                   | "                                     | Xhuherin –dafine                                            | 21b              | Pyll           | 3.5         | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 5                                          | 5                   | "                                     | Ura e peshkepise                                            | 22               | Pyll           | 7           | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 6                                          | 6                   | "                                     | Rreper drashovice                                           | 23               | Pyll           | 10          | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 7                                          | 7                   | "                                     | Dafina mallangas                                            | 24a              | Pyll           | 8           | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 8                                          | 8                   | "                                     | Gurore kallafet                                             | 24b              | Sip.boshe      | 5           | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 9                                          | 9                   | "                                     | Nen gurore –kanine                                          | 25               | Pyll           | 21.1        | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 10                                         | 10                  | "                                     | Vali beges shkambi kuq                                      | 26/1             | Kullote        | 76.1        | Per kullotje                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 11                                         | 11                  | "                                     | Guri Bufit                                                  | 27a/1            | Pyll mbrojes   | 19.2        | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 12                                         | 12                  | "                                     | Sheshet e Gurit Bufit                                       | 27b/1            | Pyll prodhus   | 7           | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 13                                         | 13                  | "                                     | Mbi kanal                                                   | 28c              | Pyll           | 7.5         | Mbrojt. Toke                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 15                                         | 15                  | EP Ana Lumit Vjose                    | Selvia Hoshtim                                              | 1                | Pyll           | 6           | Prodh. lende                          | "                                                | "                                             |                                        |
| 16                                         | 16                  | EP Kume – Shashice                    | Dushku Risili                                               | 35               | Sip.bimnes.pyj | 15.6        | Kullote                               | "                                                | "                                             |                                        |
| 17                                         | 17                  | EKull Shashic-Gumenic                 | Shpati i Ledhes                                             | 1                | Kullote        | 89          | Per kullotje                          | "                                                | "                                             | V K M Nr.700                           |
| 18                                         | 18                  | "                                     | Gropa e Beges                                               | 2                | Kullote        | 48          | Per kullotje                          | "                                                | "                                             | -                                      |
| 19                                         | 19                  | "                                     | Gropa e Kecaqit                                             | 3                | Kullote        | 31          | Per kullotje                          | "                                                | "                                             | -                                      |
| 20                                         | 20                  | "                                     | Kemba e Çaushit                                             | 5                | Kullote        | 49          | Per kullotje                          | "                                                | "                                             | -                                      |
| 21                                         | 21                  | "                                     | Qafa e Frankovecit                                          | 6                | Kullote        | 77          | Per kullotje                          | "                                                | "                                             | -                                      |
| 22                                         | 22                  | "                                     | Kemba e Memines                                             | 7                | Kullote        | 100         | Per kullotje                          | "                                                | "                                             | -                                      |
| 23                                         | 23                  | "                                     | Lugu Çobanit                                                | 11               | Kullote        | 69          | Per kullotje                          | "                                                | "                                             | -                                      |

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Qendër (Vlorë)

Lidhja nr.1

| <b>Numrat rendorë të pronave<br/>në listën e inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b> | <b>Lloji i transferimit</b> |
|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------|
| 1 - 23                                                      |                                     | Në pronësi                  |
|                                                             |                                     |                             |